



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 6613 Prot.

Fier më 22.05.2026

Projekt - Vendim

Nr. 55 Dt. 22.05.2026

“Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Enterprises Albania” sh.p.k. për dhënien e të drejtës për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve kontraktore sipas kontratës nr. 1224 rep. nr. 562 kol. dt. 18.09.2024 nga shoqëria “Enterprises Albania” sh.p.k. tek shoqëria “Glow Solar” sh.p.k. (SPV)

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më datë ____ .05.2026, i paraqitet për shqyrtim materiali i përgatitur nga Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave, bazuar në kërkesat zyrtare nr. 12154 prot. dt. 30.10.2025 dhe nr. 886 prot. dt. 23.01.2026, e shoqërisë “Enterprises Albania” sh.p.k, me lëndë *“Kërkesë për miratimin e transferimit të të drejtave dhe detyrimeve të qiramarrësit lidhur me kontratën noteriale të qirasë nr. 1224 rep. nr. 562 kol. dt. 18.09.2024”*.

Bazuar në nenin 9, pika 1.2, nenin 54, shkronja “e, e/1” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (të ndryshuar), bazuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 8744, date 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtëshme publike të shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, VKM 510 dt. 10.06.2015 *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në Njësitë e Qeverisjes Vendore, të prekura nga riorganizimi administrative – territorial”*, Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr. 109 dt. 27.11.2025 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026”, Ligji nr. 68 datë 27.04.2017, “Për Financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, « Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë » (i ndryshuar), Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë «Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit», Ligjin nr. 24/2023 *“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”*, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 349 dt. 12.06.2018 *“Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”* i ndryshuar, Kontratë e qirasë nr. 1224 rep. nr. 562 kol. dt. 18.09.2024 të lidhur ndërmjet Bashkisë Fier dhe shoqërisë “Enterprises Albania” sh.p.k., Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit me nr. 6120/3 prot. dt. 10.12.2024, i paraqesim Këshillit të Bashkisë Fier materialin mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Enterprises Albania” sh.p.k., për dhënien e të drejtës për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve kontraktore sipas kontratës nr. 1224 rep. nr. 562 kol. dt. 18.09.2024 nga shoqëria “Enterprises Albania” sh.p.k. tek shoqëria “Glow Solar” sh.p.k. (SPV)., **Kryetari i Bashkisë:**

Propozon:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Enterprises Albania” sh.p.k. për dhënien e së drejtës për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve kontraktore sipas kontratës nr. 1224 rep. nr. 562 kol. dt. 18.09.2024 nga shoqëria “Enterprises Albania” sh.p.k. me NUIS L51902031P tek shoqëria “Glow Solar” sh.p.k. (SPV) me NUIS M51403044O.
2. Të gjitha kushtet, detyrimet e tjera dhe afatet e përcaktuara në kontratën e qirasë nr.1224 rep. nr. 562 kol., dt.18.09.2024 të lidhur ndërmjet Bashkisë Fier dhe shoqërisë “Enterprises Albania” sh.p.k., mbeten të pandryshuara.
3. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Fier për nënshkrimin e akt marrëveshjes dhe çdo dokument të nevojshëm në dobi të qëllimit të saj.

Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave

Drejtor: M. Petushi

Drejtoria Juridike

Drejtor: E. Kapllanaj

Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit

Drejtor: P. Çina

Sekretar i Përgjithshëm

Nikollaq Neço

KRYETARI

Armando SUBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 6613/1 Prot.

Fier, më 22.05.2026

Relacion

“Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Enterprises Albania” sh.p.k. për dhënien e të drejtës për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve kontraktore sipas kontratës nr.1224 rep., nr.562 kol. dt.18.09.2024 nga shoqëria “Enterprises Albania” sh.p.k. tek shoqëria “Glow Solar” sh.p.k. (SPV)

Të nderuar Znj. Z. Këshilltarë!

Në Bashkinë Fier është administruar kërkesa zyrtare nr.12154 prot. dt.30.10.2025 dhe nr.886 prot. dt. 23.01.2026, e shoqërisë “Enterprises Albania” sh.p.k me NUIS L51902031P, me lëndë “*Kërkesë për miratimin e transferimit të të drejtave dhe detyrimeve të qiramarrësit lidhur me kontratën noteriale të qirasë nr. 1224 rep. nr. 562 kol. dt. 18.09.2024*”.

Shoqëria “Enterprises Albania” sh.p.k, me Nuis L51902031P dhe Bashkia Fier mbi bazën e Vendimit të Këshillit Bashkiak Fier nr.36 dt.29.03.2024 “*Për miratimin e draft marrëveshjes për sipërfaqjen e kërkuar nga projekti i shoqërisë “Enterprises Albania” sh.p.k., kanë lidhur akt – marrëveshjen nr.4440 prot.dt.18.04.2024.*

Qëllimi dhe objekti i kësaj marrëveshje është dhënia e ekskluzivitetit mbi të drejtat reale (e drejtë qiraje përdorimi, kalimi) mbi pasurinë nr.56/1 zk. 3358, pronë e Bashkisë Fier, e cila preket nga projekti i hartuar nga shoqëria “Enterprises Albania” sh.p.k. Të drejtat reale përfshijnë të drejtën e qirasë, përdorimit, kalimit, shfrytëzimit mbi pasurinë nr.56/1 zk. 3358, të cilat i jepen shoqërisë me synimin për të projektuar, ndërtuar, instaluar, operuar dhe mirëmbajtur projektin. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe në rastin e shpalljes fitues të shoqërisë në procedurën konkurruese për përzgjedhjen e projekteve për “Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e disa impianteve fotovoltaike, secili me një kapacitet të instaluar ndërmjet 10 MW dhe 100MW, të cilët do të përfitojnë masa mbështetëse, me vendndodhje të zgjedhur nga ofertuesi në Republikën e Shqipërisë, për një kapacitet maksimal prej 30 MW”.

Me qëllim marrjen pjesë/ofertim në procedurën e tenderit të publikuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë për “*Projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e impianteve diellore, secila me një minimum kapaciteti i instaluar 10 MW dhe të cilat kërkojnë mbështetje për të gjithë ose një pjesë të kapacitetit të tyre të instaluar, nga të cilat Kapaciteti i Mbështetur mund të jetë deri në 100 MW, për t’u vendosur në një zonë të zgjedhur nga një ofertues i përzgjedhur brenda Republikës së Shqipërisë*”, është nënshkruar Marrëveshja e Konsorciumit (JV) ndërmjet shoqërive - Bashkimi i Shoqërive “Solar PV” sh.pk., Elvan Gida Sanayi Ve Ticaret” A.S”, shoqëria “GR Albania” sh.p.k., shoqëria “Enterprises Albania” sh.p.k. dhe shoqëria “Rab Enterprises” sh.p.k. sipas kontratës noteriale nr.3242 rep., nr.1186 kol., dt.10.06.2024 me objekt:

“Krijimi i një Bashkimi Shoqërisë (“JV” ose “Konsorcium” me qëllim që të bashkojnë përpjekjet dhe aftësitë e tyre për të marrë pjesë në procedurën e tenderit dhe për të ekzekutuar së bashku Projektin në fazat e tij të ndryshme, të cilat përfshijnë - Pjesëmarrjen e JV -së në procedurën e tenderit si Ofertues; Themelimin e një SPV në rast se projekti i jepet JV-së; Realizimi i Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit dhe Marrëveshjes Mbështetëse me Autoritetin Kontraktor; Përbushjen e Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit dhe Marrëveshjes Mbështetëse; Palët bien dakord që të gjitha kostot për zhvillimin e projektit dhe përgatitjen e ofertës do të mbulohen bashkërisht nga palët; Palët do të bien dakord që së bashku ndërmjet tyre për detyrat, përgjegjësitë dhe kostot në formën e një Marrëveshje të brendshme pas nënshkrimit/ekzekutimit të kësaj Marrëveshje të Bashkimit të Operatorëve”.

Në nenin 2 (Afati) të Kontratës noteriale nr.3242 rep., nr.1186 kol., dt. 10.06.2024 është parashikuar

1. *“Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi deri në përbushjen e qëllimit të saj dhe në rast se projekti i jepet JV -së, deri në nënshkrimin e Marrëveshjes përfundimtare të Zhvillimit të Projektit me Autoritetin Kontraktor.*

2. *Nëse Konsorciumi nuk kualifikohet dhe nuk fiton ofertën, atëherë kjo marrëveshje do të konsiderohet automatikisht e përfunduar, përveç nëse Palët bien dakord reciprokisht për të kundërtën”.*

Nga njoftimi nr.6120 prot., dt.23.07.2024 i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, referuar procedurës konkurruese të realizuar, rezulton se Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive (JV), në të cilin bën pjesë edhe shoqëria “Enterprises Albania” sh.p.k., konkretisht Bashkimi i Shoqërive “Solar PV” sh.p.k., Elvan Gida Sanayi Ve Ticaret” A.S”, shoqëria “GR Albania” sh.p.k., shoqëria “Enterprises Albania” sh.p.k. dhe shoqëria “Rab Enterprises” sh.p.k., **është kualifikuar dhe vlerësuar nga MIE, si ofertë e përzgjedhur për zhvillimin e projektit.**

Në vijim nga ana e shoqërisë “Enterprises Albania” sh.p.k. dhe Bashkisë Fier është lidhur kontrata e qirasë nr.1224 rep., nr. 562 kol., dt.18.09.2024 me objekt **“Dhënia me qira e një sipërfaqje “tokë pa frut” e llojit “ranishte” 151 867 m², me nr. pasurie 56/1 zk. 3358 ndodhur në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier”**, për një afat kohor 20 vjeçar, me anë të të cilës janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimeve e palëve kontraktore respektive. Konkretisht në nenin 4 **“Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit”** ndër të tjera është përcaktuar **“Qiramarrësi nuk ka të drejtë të jap me nënqira pronën objekt kontrate pa miratimin e qiradhënësit”. Qiramarrësi ka të drejtën dhe detyrimin ligjor që të kryejë investimin në pronën e marr me qira, brenda një afati 5 (pesë) vjeçar nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, në të kundërt palës qiradhënëse i lind e drejta e zgjidhjes së njëanëshme të kontratës.** Nga shoqëria “Enterprises Albania” sh.p.k. janë përbushur detyrimet kontraktore financiare të parashikuara në nenin 3 të kontratës së sipërcituar.

Në zbatim të përcaktimeve ligjore të procedurës konkurruese, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive në të cilin bën pjesë edhe shoqëria “Enterprises Albania” sh.p.k, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Solar PV” sh.p.k., Elvan Gida Sanayi Ve Ticaret” A.S”, shoqëria “GR Albania” sh.p.k., shoqëria “Enterprises Albania” sh.p.k. dhe shoqëria “Rab Enterprises” sh.p.k., ka vijuar me **nënshkrimin e Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit me nr. 6120/3 prot. dt. 10.12.2024** me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Impiantit Fotovoltaik me kapacitet të instaluar 29.13 MW ac dhe Kapacitet të Mbështetur 29.13 MWac që do të vendoset në Bashkinë Fier, Shqipëri.

Bazuar në kërkesat e nenit 2.4 (c) të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit, ofertuesi, pra Bashkimi i Shoqërive (JV), **do të krijojë një Subjekt për Qëllime të Veçanta (SPV)** si një njësi ekonomike e themeluar sipas ligjit shqiptar në të cilin ofertuesi, pra JV, është aksioner i drejtëpërdrejtë ose i tërthortë kontrollues dhe i dorëzoi tek Autoriteti Kontraktues, pra tek MIE, kopje origjinale dhe të plota të Statutit të shoqërisë dhe certifikatën e regjistrimit të SPV-së.

Në këtë kuadër, në përputhje me kërkesat e nenit 2.4 (c) të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive me cilësinë e Ofertuesit ka themeluar dhe regjistruar subjektin për qëllime të veçanta (SPV), shoqërinë **“Glow Solar” sh.p.k. me NUIS M514030440** si njësi ekonomike e themeluar sipas ligjit shqiptar, e cila do të veprojë si Zhvillues (SPV) i projektit **“Impianti Fotovoltaik 29.13 Mëac Fier”**, me datë regjistrimi 03.02.2025.

Në nenin 2.5 të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit me nr.6120/3 prot. dt. 10.12.2024 të lidhur midis Bashkimit të Shoqërive (JV) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është përcaktuar: **“Në datën e regjistrimit të SPV-së në regjistrin tregtar të Shqipërisë (Data e Transferimit), të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Ofertuesit sipas kësaj Marrëveshje i transferohen Zhvilluesit.** Ofertuesi do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që ky transferim është i vlefshëm dhe i dokumentuar; të sigurojë që të gjitha kërkesat sipas kësaj marrëveshje lidhur me Zhvilluesin të përfshihen në mënyrë të duhur në dokumentet përbërëse të SPV -së.”

Në vijim, në zbatim të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit me nr.6120/3 prot. dt. 10.12.2024, për ti mundësuar shoqërisë **“Gloë Solar” sh.p.k.** ushtrimin e detyrimeve të saj ligjore si Zhvillues, shoqëria **“Enterprises Albania” sh.p.k.** në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjen e Zhvillimit nr.6120/3 prot. dt. 10.12.2024, ka detyrimin ligjor të transferojë në favor të Zhvilluesit **“Glow Solar” sh.p.k. (SPV), të drejtat reale ekskluzive mbi pasurinë nr. 56/1 zk. 3358, me sipërfaqje 151 867 m², tokë pa fruit, e llojit “ranishte”², ndodhur në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, pronë e Bashkisë Fier, e cila është objekt i kontratës noteriale të qirasë nr. 1224 rep. nr. 562 kol. dt. 18.09.2024.**

Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve nga ana e shoqërisë **“Enterprises Albania” sh.p.k.** të pasurisë nr.56/1, ZK.3358, me sipërfaqje 151 867 m², objekti i kontratës së qirasë nr.1224 rep., nr. 562 kol. dt. 18.09.2024, në favor të Zhvilluesit të Projektit, **“Gloë Solar” sh.p.k. (SPV), do të jetë me të njëjtat kushte dhe afate të përcaktuara në kontratën ekzistuese të qirasë të lidhur ndërmjet Bashkisë Fier dhe shoqërisë “Enterprises Albania” sh.p.k. dhe transferimi i të drejtave reale mbi pasurinë nuk do të çënojë të drejtat e Bashkisë Fier si pronare e pasurisë dhe as dispozitat e tjera të kontratës aktuale,** por ka për qëllim të mundësojë zbatimin praktik të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit me nr.6120/3 prot. dt. 10.12.2024 dhe financimin e tij nga investitorët e SPV-së.

Nga ana e shoqërisë **“Glow Solar” sh.p.k.** është paraqitur deklarata noteriale nr.4943 rep.,nr.2548 kol., dt.21.05.2026, me anë të të cilës ndër të tjera është marr përsipër respektimi i të gjitha kushteve dhe detyrimeve të kontratës së qirasë nr. 1224 rep. nr. 562 kol. dt. 18.09.2024 sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, si dhe detyrimet që burojnë nga Marrëveshja për Zhvillimin e Projektit me nr. 6120/3 prot. dt. 10.12.2024, të lidhur midis Bashkimit të Shoqërive (JV) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Në nenin 4, të kontratës së qirasë nr. 1224 rep. nr. 562 kol. dt. 18.09.2024, qiramarrësi shoqëria "Enterprises Albania" sh.p.k., mund të jap miratimin për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve vetëm me miratimin e qiradhënësit Bashkia Fier.

Referuar nga sa më sipër, bazuar në nenin 9, pika 1.2, nenin 54, shkronja "e, e/1" të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", (të ndryshuar), bazuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, bazuar në Ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), në Ligjin Nr.8744, date 22.02.2001,"Për transferimin e pronave të paluajtëshme publike të shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore", VKM 510 dt. 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në Njësitë e Qeverisjes Vendore, të prekura nga riorganizimi administrative – territorial", Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr.109 dt. 27.11.2025 "Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026", Ligji nr. 68 datë 27.04.2017, "Për Financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, «Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë» (i ndryshuar), Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë «Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit», Ligjin nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", Vendim i Këshillit të Ministrave nr.349 dt. 12.06.2018 "Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre" i ndryshuar, Kontratë e qirasë nr. 1224 rep. nr. 562 kol. dt. 18.09.2024 të lidhur ndërmjet Bashkisë Fier dhe shoqërisë "Enterprises Albania" sh.p.k., Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit me nr. 6120/3 prot. dt. 10.12.2024, i paraqesim Këshillit të Bashkisë Fier materialin mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë "Enterprises Albania" sh.p.k., për dhënien e të drejtës për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve kontraktore sipas kontratës nr. 1224 rep. nr. 562 kol. dt. 18.09.2024 nga shoqëria "Enterprises Albania" sh.p.k. tek shoqëria "Glow Solar" sh.p.k. (SPV).

Bashkëlidhur relacionit dokumentacioni përkatës i cituar.

Drejtorja e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave
Konc. M. Petushi

Drejtorja Juridike
Drejtores: E. Kapllanaj

Drejtorja e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit
Drejtores: P. Çina

Sekretar i Përgjithshëm
Nikollaj Neço

